

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Raporti i Auditorit të Pavarur dhe

Pasqyrat Financiare për fund vitin 31 Dhjetor 2009

**PËRMBAJTJA****FAQE**

RAPORTIT TË AUDITORIT TË PAVARUR

BILANCI I GJENDJES

3

PASQYRA E TË ARDHURAVE

4

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

5

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

6

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

7 - 27

## Raportit të Auditorit të Pavarur

Bordit të Drejtorëve të Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.a.

Ne kemi kryer auditimin e pasqyrave financiare të bashkangjitura të Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.a. (në tekstin e mëtejshëm “Kompania”), të cilat përbëhen nga pasqyra e gjendjes financiare më 31 Dhjetor 2009 dhe pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave, pasqyra e ndryshimit në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për fund vitin me atë datë, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e kontroleve të brendshme relevante për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë deklarata materialisht të gabuara, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve; duke zgjedhur dhe zbatuar politikat përkatëse të kontabilitetit; dhe duke bërë vlerësime kontabile të cilat janë të arsyeshme në ato rrethana.

### *Përgjegjësia e Auditorit*

Përgjegjësia jonë është që të shprehim opinionin mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Përveç çështjeve që janë diskutuar nga paragrafi 1 deri në paragrafin 3 më poshtë, ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhje me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim të marrjes së sigurisë së arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë deklarime të gabuara që janë materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim të sigurimit të dëshmimeve të auditimit në lidhje me shumatat dhe shënimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të deklarimeve të gabuara në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo për shkak të gabimeve. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori merr në shqyrtim kontrollin e brendshëm që është relevant në lidhje me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare nga ana e entitetit me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi po ashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të kontabilitetit që janë përdorur si dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël që janë bërë nga ana e menaxhmentit, sikurse edhe vlerësimin e përgjithshëm të prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që ne i kemi grumbulluar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

1. Siç është shpalosur në shënimin 3.2 të pasqyrave financiare, Kompania ka përdorur metoden lineare për zhvlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve. Gjatë auditimit tonë, ne kemi vërejtur se Kompania nuk ka një qasje të qëndrueshme ndaj metodave të pranuar për zhvlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve. Duke marr parasysh natyrën e të dhënave të Kompanisë, ne nuk kemi qenë të kënaqur në lidhje me saktësinë e shpenzimeve të zhvlerësimit për vitin, zhvlerësimin e grumbulluar dhe rrjedhimisht në lidhje me saktësinë e vlerësimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve me datën 31 Dhjetor 2009.
2. Ne nuk kemi marr pjesë në numërimin fizik të stoqeve më datë 31 Dhjetor 2009 apo më 31 Dhjetor 2008, pasi që të dy rastet ishin para se ne të angazhohemi (kontraktohem) si auditorë të Kompanisë. Duke marr parasysh natyrën e dhënave të Kompanisë, ne nuk kemi qenë të kënaqur në lidhje me sasinë e stoqeve më 31 Dhjetor 2009 dhe më stoqet fillestare më 1 Janar 2009 dhe ndikimin pasues në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për fund vitin 31 Dhjetor 2009.
3. Kompania nuk ka kryer llogaritjen siç duhet të tatimit në fitim aktual për fund vitin 31 Dhjetor 2009 siç parashihet me Rregulloret Kosovare për Tatimin në të Ardhurat dhe rrjedhimisht nuk përfshinë efektet e tatimeve në pasqyrat e bashkangjitura financiare. Për më tepër, Kompania nuk ka themeluar një aset apo detyrim të tatimit të shtyrë siç kërkohet sipas Standardit Ndërkombëtar të Auditimit Numër 12 “Tatimet në të Ardhura”. Në mungesë të procedurave alternative të auditimit, ne nuk kemi qenë në gjendje që të përcaktojmë nivelin e korrigjimeve, nëse do të kishte pasur, të cilat do të kishin qenë të nevojshme me qëllim të regjistrimit të tatimeve në përputhje me IAS 12, Tatimet në të Ardhura.

#### *Mangësitë në shpalosje*

4. Pasqyrat financiare të bashkangjitura nuk i përmbajnë të gjitha shpalosjet që kërkohen sipas Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (IFRS) numër 7 – Instrumentet Financiare: Shpalosjet.

#### *Opinion i Kualifikuar*

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të atyre korrigjimeve, nëse do të kishte, siç mund të jenë përcaktuar të jenë të nevojshme nëse ne do të kishim qenë në gjendje të ishim të kënaqur në lidhje me çështjet që iu jemi referuar në paragrafët 1 deri 3 më sipër, dhe përveç efekteve në pasqyrat financiare të çështjes së diskutuar në paragrafin 4 më sipër, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Kompanisë më 31 Dhjetor 2009, si dhe performansën e saj financiare dhe rrjedhën e saj të parasë për fund vitin me atë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

#### *Theksimi i çështjeve*

Duke mos e kualifikuar më tej opinionin tonë, ne tërheqim vërejtjen për çështjet e mëposhtme:

- i. Ashtu siç është diskutuar në shënimin 2.3 dhe 26 të pasqyrave financiar, këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas supozimit që Kompania do të vazhdojë të operojë sipas parimit të vazhdimësisë së afarizmit. Kompania ka regjistruar rezultat neto pozitiv për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2009 në vlerë prej 4,859 mijë Euro që rezultojë në zvogëlim humbjeve të akumuluar më 31 Dhjetor 2008 prej vlerës 603,475 mijë Euro në 598,616 mijë Euro më 31 Dhjetor 2009. Për më tepër Kompania ka pranuar grante qeveritare gjatë vitit që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2009 për importim të energjisë elektrike. Përkundër trendit pozitiv në performancën e pasqyrave financiare të Kompanisë, vazhdueshmëria e varësisë nga grantet Qeveritare për importimin e energjisë elektrike dhe humbjet e akumuluar më 31 Dhjetor 2009, ngre dyshime për aftësinë e Kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nuk është bërë asnjë korrigjim në këto pasqyra financiare që të reflektojnë këtë pasiguri.

- ii. Në vazhdimësi të paragrafit “i” më lartë dhe të faktorëve siç detajohen në notën 26 të pasqyrave financiare, ne tërheqim vëmendjen që çmimet e energjisë elektrike janë të rregulluara. Megjithatë një analizë e dëmit mbi vlerën e bartur të pronës, impianteve dhe pajisjeve nuk është kryer nga ana e Kompanisë për shkak të rrjedhës së paparashikueshme të hyrave në të ardhmen, por megjithatë menaxhmenti beson që nuk ka ndonjë rrezik domethënës (madhor) si pasojë e dëmit të shkaktuar nga rregullimi i çmimeve dhe përkrahja nga Qeveria.
- iii. Siç është shpjeguar në Shënimin 4 të pasqyrave financiare të bashkangjitura, të përfshira në ndërtesa dhe pajisje ndodhen prona të caktuara, të cilat janë nën kontroll të kompanisë, por për të cilat Kompania nuk posedon dokumente të pronësisë. Me qëllim të zgjedhjes së kësaj çështje, një proces zyrtar ende nuk ka filluar, megjithatë, Kompania veç ka filluar bisedimet me autoritetet relevante për ti kompletuar dokumentet e pronësisë.
- iv. Siç shpjegohet në Shënimin 3.17 të pasqyrave financiare të bashkangjitura, aktualisht nuk ka asnjë kërkesë ligjore në Kosovë për njohjen provizioneve lidhur me mjedisin, çaktivizimin dhe dispozita tjera të ngjashme. Kompania është duke e bartur një provizion për largimin e grumbujve të hirit që nga korporatizimi i saj në vitin 2005 në shumën prej 30 milionë Euro i cili ishte bazuar në një studim të jashtëm në 2005 dhe rivlerësimit të brendshëm nga ana e Kompanisë me 31 Dhjetor 2009. Në vitin 2009 Kompania ka regjistruar edhe provizionet për çaktivizim në shumën totale prej 14,000 mijë Euro. Siç është shpjeguar në shënimin 13, duke u bazuar në vlerësimin e brendshëm të Kompanisë, janë edhe disa provizione të ambientit, dekomisionimit si dhe provizione të tjera të ndërlidhura në vlerë prej 44,000 mijë Euro. Kompania rregullisht kryen vlerësimet e saj të brendshme për provizione të tilla dhe i njeh ato varësisht prej natyrës dhe rrethanave që kanë të bëjnë me këto provizione. Varësisht prej natyrës dhe madhësisë së operacioneve të Kompanisë në të ardhmen dhe ndonjë ndryshimi të mundshëm në kornizën ligjore të Kosovës, rezultatet aktuale mund që materialisht të ndryshojnë nga vlerësimet e Kompanisë.

#### Çështje të tjera:

Si është shpjeguar në shënimin 27 të këtyre pasqyrave financiare, Qeveria e Kosovës është duke planifikuar të privatizoj njësit e caktuara të Kompanisë në të ardhmen. Operimi i Kompanisë në të ardhmen mund të ndikohen nga këto ngjarje. Auditimi ynë nuk është bërë për qëllim të ndonjë transaksioni të këtille apo për ndonjë transaksion të ngjashëm me palët e tjera. Palët e tjera duhet që ti kryejnë vlerësime të tjera apo vlerësime due diligence. Deri në nivelin më të plotë që lejohet me ligj, ne nuk pranojmë apo supozojmë përgjegjësi ndaj asnjërit përveç kompanisë dhe aksionarëve të Kompanisë si një organ, për punën tonë, për këtë raport apo për opinionin që ne kemi formuluar.

Ky raport është përkthim i versionit original në anglisht, në rast kontesti midis këtyre dy raporteve, përparësi ka ai në gjuhën angleze.

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Pasqyra e Gjendjes Financiare më 31 Dhjetor 2009**

Shënimet	Më 31 Dhjetor, 2009 (në '000 Euro)	Më 31 Dhjetor 2008 (në '000 Euro)
<b>ASETET</b>		
<b>Asetet jo-rrjedhëse</b>		
Prona, impiantet dhe pajisjet	4	294,511
Asetet e paprekshme	5	227
	<u>294,738</u>	<u>235,992</u>
<b>Asetet rrjedhëse</b>		
Stoqet	6	23,245
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	80,639
Paraja në dorë dhe në banka	8	20,515
	<u>124,399</u>	<u>79,325</u>
<b>GJITHSEJT ASETET</b>	<u><b>419,137</b></u>	<u><b>315,317</b></u>
<b>EKUITETI DHE DETYRIMET</b>		
<b>Ekuiteti i aksionarëve</b>		
Kapitali aksionar	9	25
Rezervat	10	688,082
Humbjet e bartura nga vitet paraprake		(603,475)
Fitimi ( humbja) për vitin		4,859
		<u>(1,945)</u>
	<u>89,491</u>	<u>84,632</u>
<b>Detyrimet jo-rrjedhëse</b>		
Huamarrjet – afatgjata	11	86,953
Grantet e shtyra	12	124,618
Provizionet	13	49,211
		<u>260,782</u>
<b>Detyrimet rrjedhëse</b>		
Huamarrjet – afatshkurta	11	10,587
Llogarit e pagueshme dhe të tjera	14	51,008
Shpenzimet akruale	15	7,269
		<u>68,864</u>
<b>GJITHSEJT EKUITETI DHE DETYRIMET</b>	<u><b>419,137</b></u>	<u><b>315,317</b></u>

Autorizuar për botim nga ana e menaxhmentit dhe e nënshkruar në emër të tyre më 16 Gusht 2010

Ztr. Arben Gjukaj

Ztr. Salih Bytyqi

Drejtore Menaxhues

Drejtore I Financave

Shënimet e bashkangjitura prej 1 deri në 27 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.****Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për fund vitin 31 Dhjetor 2009**

	Shënimet	Fund vitin 31 Dhjetor 2009 (në '000 Euro)	Fund vitin 31 Dhjetor 2008 (në '000 Euro)
<b>TË HYRAT OPERATIVE</b>			
Shitjet	16	174,392	163,043
Të hyrat nga grantet	17	58,472	47,695
Të hyrat tjera	18	5,044	6,909
		<u>237,908</u>	<u>217,647</u>
<b>SHPENZIMET OPERATIVE</b>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4&5	(23,920)	(22,417)
Shpenzimet e stafit	19	(46,657)	(43,677)
Energjia elektrike dhe shërbimet tjera publike	20	(83,109)	(85,527)
Shpenzimet e mirëmbajtjes		(8,217)	(7,825)
Materialet dhe furnizimet		(10,938)	(8,521)
Provizionet për shlyerjen e stoqeve	6	-	(5,765)
Humbja nga shlyerja e llogarive të arkëtueshme	7	(25,625)	(31,491)
Shpenzimet e provizioneve për mjedis dhe çështje tjera	13	(19,211)	-
Shpenzimet tjera operative	21	(15,218)	(13,618)
		<u>(232,895)</u>	<u>(218,841)</u>
<b>Fitimi/(humbja) nga operacionet</b>		<b>5,013</b>	<b>(1,194)</b>
Ngarkesat financiare, neto	22	(154)	(751)
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>		<b>4,859</b>	<b>(1,945)</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	23	-	-
<b>Fitimi neto/(humbja) për vitin</b>		<b>4,859</b>	<b>(1,945)</b>
Të hyra tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Gjithsej të hyrat (humbja) gjithëpërfshirëse</b>		<b>4,859</b>	<b>(1,945)</b>

Shënimet e bashkangjitura prej 1 deri në 27 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet për fund vitin 31 Dhjetor 2009**

---

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Rezervat</b>	<b>Humbjet e mbajtura</b>	<b>Totali</b>
	----- (në '000 Euro) -----			
Gjendja me 1 Janar 2008	<b>25</b>	<b>687,889</b>	<b>(601,530)</b>	<b>86,384</b>
Humbja për vitin	-	-	(1,945)	<b>(1,945)</b>
Lirimi i impairmentit në asetet e shlyera	-	193	-	<b>193</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2008</b>	<b>25</b>	<b>688,082</b>	<b>(603,475)</b>	<b>84,632</b>
Profiti për vitin	-	-	4,859	<b>4,859</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>25</b>	<b>688,082</b>	<b>(598,616)</b>	<b>89,491</b>

**Shënimet e bashkangjitura prej 1 deri në 27 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.**



**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për fund vitin 31 Dhjetor 2009**

	Shënimet	Fund vitin 31 Dhjetor 2009 (në '000 Euro)	Fund vitin 31 Dhjetor 2008 (në '000 Euro)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Neto profiti / (humbja) para tatimit		4,859	(1,945)
Korrigjimet për zërat jo-para:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	<b>4&amp;5</b>	23,920	22,417
Të hyrat nga grantet		(58,472)	(47,695)
Provizionet për borxhet e dyshimta		25,625	31,491
Provizionet shpenzimet e ambientit dhe pensionimit të punëtorëve		19,211	-
Provizionet për shlyerjen e stoqeve		(596)	5,765
Humbja nga hedhja e pronës, impianteve dhe pajisjeve		139	332
<b>Deficiti operativ para ndryshimeve në asetet dhe detyrimet operative</b>		<b>14,686</b>	<b>10,365</b>
(Rritja)/zvogëlimi i stoqeve		(8,092)	(8,965)
Rritja në llogaritë e arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		(41,616)	(58,260)
Rritja në llogaritë e pagueshme dhe të tjera		(2,688)	1,031
<b>Paraja e gjeneruar nga/(e përdorur në) aktivitetet operative</b>		<b>(37,710)</b>	<b>(55,829)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive</b>			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve	<b>4</b>	(82,772)	(36,982)
Blerja e asetëve të paprekshme	<b>5</b>	(33)	(203)
<b>Paraja e përdorur në aktivitetet investive</b>		<b>(82,805)</b>	<b>(37,185)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese:</b>			
Grantet e pranuar gjatë vitit		64,197	87,744
Neto kreditë e pranuar gjatë vitit		76,713	487
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese</b>		<b>140,910</b>	<b>88,231</b>
<b>Neto zvogëlimi i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b>		<b>20,395</b>	<b>(4,783)</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		120	4,903
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>		<b>20,515</b>	<b>120</b>

Shënimet e bashkangjitura prej 1 deri në 27 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

## **1. TË PËRGJITHSHME**

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a. (“Kompania” apo “KEK-u”) është Kompani aksionare e inkuorporuar në Kosovë dhe e regjistruar sipas Regjistrimit të Përkohshëm të Bizneseve me numër regjistrimi 70325399 me datë 27 Dhjetor 2005. Kompania është transformuar në shoqëri aksionare (Sh.a.) sipas rregullores numër 2001/6 të Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK”). Adresa e zyrës së saj kryesore të regjistruar është: Sheshi “Nënë Tereza” Nr. 36, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Kapitali fillestar i regjistruar i kompanisë kap shumë prej 25 mijë euro. Librat e Kompanisë janë hapur duke filluar me datën 1 Janar 2005 duke u bazuar në Raportin Financiar të Kujdesit të Duhur me datë 1 Janar 2005 nga ana e një vlerësuesi të pavarur.

Kompania është 100% pronë Korporatës Energjetike të Kosovës Holding Sh.a. ku në përputhje me ligjin numër 03/L-087 të datës 13 Qershor 2008 mbi “Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike”, Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. - “KEK SH.A.” është në pronësi të Republikës së Kosovës.

Aktivitetet kryesore të kompanisë janë prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, aktivitetet minerare si dhe nxjerrja e linjtit i cili përdoret në termoelektranat e tij.

Struktura aktuale operative e Kompanisë përbëhet nga zyra qendrore dhe divizionet vijuese:

- Divizioni për Prodhim të Qymyrit;
- Divizioni për Prodhimin e Energjisë Elektrike;
- Divizioni i Rrjetit;
- Divizioni i Furnizimit;
- Divizioni i Burimeve Njerëzore;
- Divizioni për Mbështetje të Biznesit;
- Shërbimet e Korporatës;
- Zyra e Auditimit të Brendshëm; dhe
- Divizioni i Financave.

## **2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“IFRS”).

### **2.2 Baza e përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike përveç rastit të rivlerësimit të disa asetëve dhe detyrimeve financiare.

## **2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)**

### **2.3 Parimi i vazhdueshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke u bazuar në parimin e vazhdueshmërisë. Siç tregohet në pasqyrat financiare, Kompania ka regjistruar një rezultat neto pozitiv për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2009 në vlerë prej 4,859 mijë Euro që rezultojë nga zvogëlimin e humbjeve të akumuluar humbjeve më 31 Dhjetor 2008 në vlerë prej 603,475 mijë Euro në 598,616 mijë Euro më 31 Dhjetor 2009. Ashtu siç është shpjeguar në shënimin 17, Kompania ka pranuar grante qeveritare gjatë vitit që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2009 për importimin e energjisë elektrike dhe faktorët që kanë ndikuar për njohjen e shlyerjeve në mjetet e Kompanisë më 1 Janari 2005 janë përmirësuar dukshëm (faturimi dhe arkëtimi për më shumë se 30% që nga 1 Janari 2005 dhe ndihmat e qeverisë për shpenzimet kapitale janë zëvendësuar me kredi gjatë vitit 2009, etj.). Shih gjithashtu notën 26 lidhur me diskutimet e prodhimit dhe humbjet.

### **2.4 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën e tanishme**

Ndryshimet në vazhdim të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi I Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e lëshuara nga Komisioni Ndërkombëtarë I Interpretimeve të Raportimit Financiar janë në fuqi në periudhën e tanishme:

- **IFRS 8 “Segmentet Operative”** ( në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas datës 1 Janar 2009)
- **Përmirësimet e IFRS 7 “Instrumentet Financiare: Shpalosjet”** – Përmirësimi i shpalosjeve në lidhje me instrumentet financiare (fuqi për fund vitet që fillojnë më/ pas datës 1 Janar 2009),
- **Përmirësimet e IFRS 1 “Adoptimi për herë të parë i IFRS” dhe IAS 27 “Pasqyrat financiare të konsoliduar dhe të veçanta”** – Kostoja e investimit në kompani vartëse, me kontroll të përbashkët apo kompani të ndërlidhura (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas datës 1 Janar 2009).
- **Përmirësimet në standarde dhe interpretime të ndryshme** që rezultojnë nga projektet vjetore për përmirësimin e kualitetit të IFRS-ve të publikuara më 22 Maj 2008 (IAS 1, IFRS 5, IAS 8, IAS 10, IAS 16, IAS 19, IAS 20, IAS 23, IAS 27, IAS 28, IAS 29, IAS 31, IAS 34, IAS 36, IAS 38, IAS 39, IAS 40, IAS 41) kryesisht me qëllim të largimit të mospërputhjeve dhe për qartësim të shprehjeve të përdorura (shumica e përmirësimeve duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas datës 1 Janar 2009),
- **Përmirësimet në IAS 32 “Instrumentet financiare: Prezantimi” dhe IAS 1 “Prezantimi i Pasqyrave Financiare”** – Instrumentet financiare me të drejtë shitje si dhe obligimet që shfaqen pas likuidimit (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas datës 1 Janar 2009),
- **IAS 1 (i korrigjuar) “Prezantimi i pasqyrave financiare”** – Një prezantim i korrigjuar (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas datës 1 Janar 2009).
- **IAS 23 (i korrigjuar) “Kostot e Huamarrjeve”** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas datës 1 Janar 2009),
- **Korrigjimet e IFRS 2 “Pagesat me bazë në aksione”** – Kushtet të cilat japin të drejtën dhe heqjen e të drejtës (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas datës 1 Janar 2009),
- **Korrigjimet e IFRIC 9 “Rivlerësimi i Derivateve të Padukshme” dhe IAS 39 “Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja”** - Derivateve të Padukshme (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas datës 30 Qershor 2009),
- **IFRIC 13 “Programet për Lojalitet ndaj Konsumatorëve”** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas datës 1 Korrik 2008),
- **IFRIC 15 “Marrëveshjet për Ndërtimin e Patundshmërive”** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas datës 1 Janar 2009),
- **IFRIC 16 “Fiksim të Neto Investimeve në Operacionet e Jashtme”** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas datës 1 Tetor 2008),

Adoptimi i këtyre ndryshimeve të standardeve ekzistuese dhe interpretimeve nuk ka çuar në ndryshime të rëndësishme në politikat kontabile të Kompanisë.

## **2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)**

### **2.5 Standardet dhe interpretimet në lëshim dhe nuk janë adoptuar ende**

Me datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet dhe interpretimet vijuese kanë qenë në lëshim por nuk kanë qenë në fuqi:

- **IFRS 9 “Instrumentet Financiare”** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2013),
- **IFRS 3 (I rishikuar) “Kombinimet e Biznesit”** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Korrik 2009),
- **IFRS 1 (I rishikuar) “Adoptimi për here të parë i IFRS”** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Korrik 2009),
- **Përmirësimet e IFRS 1 “Adoptimi për here të parë i IFRS”**- Përgjashtime shtesë për adoptuesit për here të parë (në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2010),
- **Përmirësimet e IFRS 2 “Pagesat më bazë në aksione” – marrëveshjet ne grupe të parave të gatshme pagesat e bazuara ne aksione** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2010),
- **Përmirësimet e IAS 24 “ Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura”** Thjeshtimi i kërkesave të shpalosjes për qeverinë- entiteteve të lidhura dhe sqarimi i definicionit për palët e lidhura (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2011),
- **Përmirësimet e IAS 27 “ Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale ”** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Korrik 2009 ),
- **Përmirësimet e IAS 32 “Instrumentet Financiare :Prezantimi ”** – Kontabilitet për çështjet e të drejtave (në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 Shkurt 2010),
- **Përmirësimet e IAS 39 “ Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja”** Fiksimi i drejt i njërive (në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 Korrik 2009),
- **Përmirësimet në standarde dhe interpretime të ndryshme** që rezultojnë nga projektet vjetore për përmirësimin e kualitetit të IFRS-ve të publikuara më 16 Prill 2009 (IFRS 2, IFRS 5, IFRS 8, IAS 1, IAS 7, IAS 17, IAS 18, IAS 36, IAS 38, IAS 39, IFRIC 9, IFRIC 16) kryesisht me qëllim të largimit të mospërputhjeve dhe për qartësim të shprehjeve të përdorura (shumica e përmirësimeve duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2010),
- **Përmirësimet e IFRIC 14 “IAS 19 – Kufizimi I definimit të një asemi përfitimi, Kërkesat minimale të financimit dhe bashkëveprimi i tyre ”** Parapagimet e një kërkesë minimale të financimit (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2011),
- **IFRIC 17 “ Shpërndarjet e pasurive jo-kesh për pronarët ”** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Korrik 2009),
- **IFRIC 18 “ Transferet e Aseteve nga Konsumatorët”** (në fuqi për transferimin e asetëve nga konsumatorët, i pranuar më ose pas datës 1 Korrik 2009 ),
- **IFRIC 19 “Asgjësimi i Detyrimeve më Instrumentet e Ekuitetit”** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Korrik 2010).

Kompania ka zgjedhur që të mos adoptoj këto standarde, korigjime dhe interpretime para datës së hyrjes së tyre në fuqi. Kompania parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, korigjimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare në periudhën e zbatimit të tyre fillestar.

### **2.6 Valuta e prezantimit**

Valuta prezantuese dhe raportuese e Kompanisë është Euroja (EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Euroja ishte adoptuar si valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej datës 1 Janar 2002.

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT**

#### **3.1 Transaksionet në valutë të huaj**

Transaksionet në valutë të huaj përveç Euros regjistrohen sipas kursit të këmbimit në fuqi në datën e transaksionit. Ndryshimet e këmbimit si rezultat i zgjidhjes së transaksioneve në valutë të huaj përveç Euros përfshihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur kursin e këmbimit i cili është në fuqi në atë datë.

Asetet dhe detyrimet monetare të shndërruara në valuta tjera përveç Euros kthehen në Euro sipas kursit mesatar të këmbimit në treg në datën e bilancit të gjendjes. Fitimet dhe humbjet në valuta të huaja që ndodhin për shkak të këmbimit të aseteve dhe detyrimeve reflektohen në pasqyrën e të ardhurave si difference ndërmjet fitimeve dhe humbjeve për shkak të shndërrimit të kursit të këmbimit.

#### **3.2 Prona, impiantet dhe pajisjet**

Artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve me 1 Janar 2005 deklarohen sipas kostos së vlerësuar minus zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi, përderisa artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve të blera pas 1 Janarit 2005 deklarohen sipas kostos minus zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi nëse ka pas.

Kostoja e vlerësuar paraqet vlerat fillestare të aseteve të vlerësuara nga Kompania me ndihmën e një konsulenti të pavarur në kohën e konvertimit nga Korporata në Shoqëri Aksionare më 1 Janar 2005.

Kostot pasuese janë të përfshira në vlerën bartëse të aseteve apo njihen si një aset i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur besohet që përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me asetin do të rrjedhin për Kompaninë dhe kostoja e asetit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet ngarkohen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën ato kanë ndodhur.

‘Toka dhe pyjet’ mbahen sipas kostos së vlerësuar dhe nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi në asetet tjera llogaritet duke përdorur metodën lineare për të shpërndarë koston e tyre ose shumën e rivlerësuar në vlerën e tyre të mbetur gjatë kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit siç vijon:

Toka në mihje	6 - 50 vite
Ndërtesat	10 - 50 vite
Pajisjet e rënda industriale	10 – 15 vite
Automjetet	6 - 7 vite
Orenditë, montimet dhe pajisjet	5 - 7 vite

Vlera e mbetur e aseteve dhe koha e përdorimit rishikohet, dhe korigjohet nëse është nevoja, në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera e bartur e asetit shlyhet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera e bartur e asetit është më e madhe se shuma e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga largimi nga përdorimi përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e bartur. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**

#### **3.3 Asetet e paprekshme**

Asetet e paprekshme përbëhen nga softuerët e licencuar për kompjuterë. Këto fillimisht deklarohen sipas kostos së tyre dhe më pas sipas kostos minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metodën lineare përdorisa kostoja e një aseti të paprekshëm shlyhet përgjatë kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit.

Kompania ka regjistruar koston e vlerësuar të aseteve, më 1 Janar 2005, në bazë të shumës bruto, ku kostoja historike dhe dëmtimi deklarohen ndarazi dhe efektet e ndonjë shlyerjeje gjatë periudhave reflektohen në përputhje me to.

#### **3.4 Dëmtimi i aseteve jo-financiare**

Asetet që kanë kohë të pakufizuar të përdorimit nuk i nënshtrohen përdorimit dhe testohen në baza vjetore për dëmtim. Asetet të cilat i nënshtrohen amortizimit rishikohen për dëmtim kurdoherë kur ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera e bartur mund të mos jetë e rikuperueshme. Humbja nga dëmtimi njihet për shumën me të cilën vlera e bartur e asetit e tejkalon shumën e rikuperueshme të atij aseti. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës reale të asetit minus kostoja e shitjes dhe vlera në përdorim. Për qëllime të vlerësimit të dëmtimit, asetet grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat ekzistojnë rrjedha të identifikueshme të veçanta të parave (njësi që gjenerojnë para). Asetet jo-financiare që kanë pësuar dëmtime rishikohen për rikthime të mundshme të dëmtimit në secilën datë raportuese.

#### **3.5 Asetet dhe detyrimet financiare**

Asetet dhe detyrimet financiare që ndodhen në bilanc të gjendjes përfshijnë paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet. Politikat e kontabilitetit mbi njohjen dhe matjen e këtyre zërave janë të shpalosura në politikat përkatëse të kontabilitetit që janë të përfshira në këtë shënim. Kompania i klasifikon instrumentet e saja financiare si asete, detyrime apo ekuitet në përputhje me substancën e marrëveshjes së ndërlidhur kontraktuale. Interesat, fitimet dhe humbjet që lidhen me instrumentet financiare të klasifikuara si asete ose detyrime raportohen si të hyra ose shpenzime, respektivisht. Instrumentet financiare thyhen kur Kompania ka një të drejtë të zbatuar me ligj për të bërë thyerjen dhe ka për qëllim që ta zgjidh ose në baza neto apo që të realizojë asetin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

#### **3.6 Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare njihen fillimisht sipas vlerës së tyre reale dhe më pas maten sipas shumës së rikuperueshme, minus provizionet për dëmtime. Një provizion për dëmtimet në llogaritë e arkëtueshme tregtare vendoset kur ekzistojnë dëshmi objektive se Kompania nuk do të jetë në gjendje që të mbledh të gjitha shumat që ia kanë borxh sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme. Vështirësitë e theksuara financiare të debitorit, mundësia që debitori do të hyjë në bankrotim apo riorganizim financiar, dhe mospagim apo gabimet në pagesa (tejkallimet për më tepër se 30 ditë) konsiderohen si indikatorë që llogaritë e arkëtueshme tregtare janë dëmtuar.

Vlera e bartur e asetit zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie të lejimit, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave. Kur një llogari e arkëtueshme nuk mund të arkëtohet, ajo shlyhet përkundër një llogarie lejimi për llogaritë e arkëtueshme. Arkëtimet pasuese të shumave paraprakisht të shlyera kreditohen në pasqyrën e të ardhurave.

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**

#### **3.7 Stoqet**

Materialet, pjesët rezervë dhe materiali shpenzues, kryesisht lidhen me elektranat, mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, dhe vlerësohen sipas parimit të çmimit më të ulët ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e shkaktuara në sigurimin e stoqeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin dhe konditat ekzistuese. Vlera neto e realizueshme paraqet çmimin e vlerësuar të shitjes në kursin e zakonshëm të biznesit, minus shpenzimet e aplikueshme variabile të shitjes. Materialet dhe pjesët rezervë shpenzohen apo kapitalizohen me impiantet, sipas nevojës, kur të instalohen. Një provizion për stoqet me lëvizje të ngadalshme apo ato të vjetruara (duke përjashtuar qymyrin dhe karburantet) njihet në pasqyrën e të ardhurave, sipas vlerësimit më të mirë të menaxhmentit.

**Qymyri:** Kompania nxjerr qymyrin e saj, i cili përdoret në procesin e prodhimit për gjenerimin e energjisë elektrike në termocentralet e saj, nga dy minierat me të cilat operon. Stoqet e qymyrit deklarohen sipas kostos, që përfshin kostot direkt të nxjerrjes dhe një pjesë përkatëse të shpenzimeve indirekte që janë shkaktuar gjatë nxjerrjes së qymyrit.

#### **3.8 Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme**

Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme përfshijnë paratë e gatshme në dorë dhe në bankë. Për qëllime të rrjedhës së parasë paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme paraqesin paratë e gatshme në dorë dhe depozitat e pakufizuara në banka me periudhë maturimi prej 3 muaj ose më pak.

#### **3.9 Huamarrjet**

Huamarrjet paraqesin kreditë që janë marr nga institucionet financiare dhe qeveritare dhe maten sipas vlerës së tyre reale në kohën e njohjes fillestare dhe pas njohjes fillestare sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

#### **3.10 Kostot e përfitimeve të pensionimit**

Kompania nuk bënë provizionin dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve përveç atyre të paguara pranë Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), referojuni edhe notës 25 gjithashtu.

#### **3.11 Tatimi**

Tatimi jepet në pasqyrat financiare në përputhje me rregulloret tatimore të Kosovës që janë aktualisht në fuqi (Ligji nr. 03/L-113 i datës 18 Dhjetor 2008 “Mbi tatimin në të ardhurat e korporatave”).

Ngarkesa për tatimin në të ardhura në pasqyrën e të ardhurave për vitin përmban tatimin aktual në të ardhura. Tatimi aktual llogaritet në bazë të profitit të tatueshëm që pritet për vitin duke përdorur shkallët tatimore në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Profiti i tatueshëm ndryshon nga profiti që raportohet në pasqyrën e të ardhurave për shkak se ai nuk përfshin zërat e të hyrave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme apo të zbritshme në vitet tjera dhe më tej ai nuk përfshin zërat që asnjëherë nuk tatimohen ose nuk janë të zbritshëm. Tatimet përveç tatimit në të ardhura regjistrohen si shpenzime operative.

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**

#### **3.12 Njohja e të hyrave**

Të hyrat nga shitja e energjisë elektrike përmbajnë vlerën e faturuar të energjisë elektrike të dorëzuar. Faturimet për shitjet e energjisë elektrike bëhen çdo muaj brenda pesë (5) ditëve të para të muajit pasues në të cilin është konsumuar energjia elektrike.

#### **3.13 Grantet qeveritare**

Grantet qeveritare nuk njihen derisa të ekzistojë siguri e arsyeshme që Kompania do të respektojë kushtet e këtyre granteve dhe që ato grante do të pranohen.

Grantet qeveritare kushti kryesor i të cilave është që Kompania duhet të blejë, ndërtojë ose në ndonjë mënyrë tjetër të sigurojë asete jo-rrjedhëse njihen si të hyra të shtyra në bilancin e gjendjes dhe transferohen në pasqyrën e të ardhurave në bazë sistematike dhe racional përgjatë kohës së përdorimit të aseteve përkatëse.

Grantet tjera qeveritare njihen si e hyrë gjatë periudhave të nevojshme për t'i barazuar ato me shpenzimet të cilat ato kanë për qëllim t'i kompensojnë, në mënyrë sistematike. Grantet qeveritare që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet apo humbjet që tani kanë ndodhur apo që kanë për qëllim dhënien e përkrahjes së menjëhershme financiare për Kompaninë pa shpenzime që lidhen me të ardhmen njihen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

#### **3.14 Provizionet**

Një provizion njihet kur Kompania ka një detyrim të tanishëm si rezultat i një ngjarjeje në të shkuarën dhe është e besueshme që një rrjedhë e burimeve që paraqesin përfitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të paguar një detyrim, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet në lidhje me shumë e obligimit. Provizionet rishikohen gjatë secilës datë të bilancit të gjendjes dhe korrigjohen me qëllim që të reflektojnë vlerësimin më të mirë aktual. Kur efekti i vlerës në kohë të parasë është material, shuma e provizionit është vlere e tanishme e shpenzimeve të cilat priten të jenë të nevojshme për të paguar obligimin.

#### **3.15 Zotimet dhe kontingjentet**

Detyrimet kontigjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Një detyrim kontingjent shpaloset në të gjitha rastet përveç rasteve kur mundësia e rrjedhës së burimeve që paraqesin përfitime ekonomike është e largët. Një aset kontingjent nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundur. Shuma e një humbjeje kontigjente njihet si provizion nëse është e besueshme që ngjarjet në të ardhmen do të konfirmojnë që, një detyrim ka ndodhur deri më datën e bilancit të gjendjes dhe se mund të bëhen një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes që pason.



### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**

#### **3.16 Gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit të Kompanisë**

Në aplikimin e politikave të kontabilitetit, të cilat janë të përshkruara në Shënimin 3, nga menaxhmenti kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumat e bartura të aseteve dhe detyrimeve të cilat nuk janë lehtësisht të qarta nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorët tjerë të cilët konsiderohen të jenë relevantë. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshëm nga këto vlerësime.

#### **3.17 Burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim**

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen, dhe burimet tjera kryesore të pasigurisë në vlerësim në datën e bilancit të gjendjes, të cilat paraqesin një rrezik domethënës për të shkaktuar korrigjime materiale në vlerën e bartur të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit financiar vijues, janë diskutuar më poshtë:

##### *Provizioni për llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe stoqet:*

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësime për kthimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme dhe stoqeve. Duke u bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e kërkesave dhe shlyerjen e stoqeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

##### *Vlerësimi i rasteve ligjore:*

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën një vlerësim për shumat që nevojiten për shlyerjen e rasteve ligjore sipas udhëzimit të këshilltarit ligjor të Kompanisë. Në bazë të këtij vlerësimi, kompania në përputhje me këtë regjistron provizionin, nëse ka, apo shpalos detyrimin kontingjent. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

##### *Vlerësimi për çështjet ambientale, çaktivizimin dhe çështjet tjera të ndërlidhura*

Aktualisht nuk ka asnjë kërkesë detyruese ligjore për mjedisin, çaktivizimin dhe dispozitat tjera të lidhura në Kosovë. Kompania rregullisht kryen vlerësimet e saj të brendshme për provizionet e tilla dhe i njeh ato varësisht prej natyrës dhe rrethanave rreth këtyre provizioneve. Në varësi të natyrës dhe madhësisë së operacioneve të Kompanisë në të ardhmen dhe duke marr parasysh ndonjë ndryshim të mundshëm në kornizën ligjore në Kosovë, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet e Kompanisë.

Më 31 Dhjetor 2009, Kompania ka afersisht 202 milion Euro si kosto të vlerësuara nga brenda vetë, që kanë të bëjnë më mjedisin, ujin dhe pastrimin e ajrit, kontrollin e emisionit të pluhurit dhe përmirësimin e infrastrukturës. Kompania nuk i ka njohur këto shpenzime për shkak të mungesës së kërkesave ligjore.

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për fund vitin 31 Dhjetor 2009**

**4. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET**

	<b>Toka dhe pyjet</b>	<b>Toka në miniera</b>	<b>Ndërtesat</b>	<b>Pajisjet</b>	<b>Ndërtimet në progres</b>	<b>Totali</b>
	<b>(në '000 Euro)</b>	<b>(në '000 Euro)</b>	<b>(në '000 Euro)</b>	<b>(në '000 Euro)</b>	<b>(në '000 Euro)</b>	<b>(në '000 Euro)</b>
<b>Kostoja/ Kostoja e vlerësuar</b>						
Më 1 Janar 2008	18,650	13,168	94,575	222,544	12,188	361,125
Shtesat	-	-	2,026	13,402	1,464	16,892
Donacionet	-	384	5,689	5,354	17,267	28,694
Shlyerjet	(15)	-	(8)	(464)	-	(487)
Transferet e brendshme	(1,334)	1,334	1,921	8,112	(10,033)	-
Dëmtimi i liruar nga asetet e shlyera	-	-	-	(34)	(159)	(193)
<b>Më 31 Dhjetor 2008</b>	<b>17,301</b>	<b>14,886</b>	<b>104,203</b>	<b>248,914</b>	<b>20,727</b>	<b>406,031</b>
Shtesat	-	-	1,854	21,593	52,492	75,939
Donacionet	-	-	220	280	6,333	6,833
Transferet e brendshme	-	-	3,093	997	(4,090)	-
Shlyerjet	-	-	(191)	(1,020)	-	(1,211)
<b>Më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>17,301</b>	<b>14,886</b>	<b>109,179</b>	<b>270,764</b>	<b>75,462</b>	<b>487,592</b>

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për fund vitin 31 Dhjetor 2009**

**4. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET (VAZHDIM )**

	<b>Toka dhe pyjet</b>	<b>Toka në miniera</b>	<b>Ndërtesat</b>	<b>Pajisjet</b>	<b>Ndërtimet në progres</b>	<b>Totali</b>
	<b>(në '000 Euro)</b>	<b>(në '000 Euro)</b>	<b>(në '000 Euro)</b>	<b>(në '000 Euro)</b>	<b>(në '000 Euro)</b>	<b>(në '000 Euro)</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>						
Më 1 Janar 2008	-	5,722	39,197	103,362	-	148,281
Largimi i zhvlerësimit të akumuluar në asetet e hedhura	-	-	(3)	(344)	-	(347)
Shpenzimi për vitin	-	1,649	5,208	15,519	-	22,376
<b>Më 31 Dhjetor 2008</b>	<b>-</b>	<b>7,371</b>	<b>44,402</b>	<b>118,537</b>	<b>-</b>	<b>170,310</b>
Shpenzimi për vitin	-	1,654	5,654	16,535	-	23,843
Heqja nga shlyerja e asetëve	-	-	(166)	(906)	-	(1,072)
<b>Më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>-</b>	<b>9,025</b>	<b>49,890</b>	<b>134,166</b>	<b>-</b>	<b>193,081</b>
<b>Vlera neto në libra</b>						
<b>Më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>17,301</b>	<b>5,861</b>	<b>59,289</b>	<b>136,598</b>	<b>75,462</b>	<b>294,511</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2008</b>	<b>17,301</b>	<b>7,515</b>	<b>59,801</b>	<b>130,377</b>	<b>20,727</b>	<b>235,721</b>

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për fund vitin 31 Dhjetor 2009**

**4. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET (VAZHDIM)**

**Donacionet në materiale**

Gjatë vitit 2009, Kompania ka pranuar donacione jo-në-para në total prej 6,833,000 Euro (2008: 28,694,000 Euro) të cilat janë regjistruar në kontabilitet përmes llogarisë së granteve të shtyra. Zhvlerësimi i ndërlidhur i këtyre aseteve për vitin 2009 i cili është ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave në shumën prej 4,490,000 Euro (2008: 4,171,000 Euro) ka shkaktuar lirim të një shume të barabartë nga bilanci i granteve të shtyra (shih Shënimin 17).

**Asetet e dhëna me qira operative**

Të përfshira në bilancin e pronës, impianteve dhe pajisjeve janë asete të caktuara më 31 Dhjetor 2009, të cilat paraqesin asete që u janë dhënë me kushte të qirasë operative disa njësive organizative të ndara nga Kompania gjatë vitit 2006, sikurse edhe disa entiteteve tjera.

Më 31 Dhjetor 2008 pajisjet e Kompanisë dhe paisjet e mihjes janë vënë si kolateral kundrejt një kredie të marrë nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (shih Shënimin 11).

Të përfshira në ndërtesa dhe pajisje ndodhen prona të caktuara, të cilat janë nën kontroll të kompanisë, por për të cilat Kompania nuk posedon dokumente të pronësisë. Me qëllim të zgjedhjes së kësaj çështje, një proces zyrtar ende nuk ka filluar, megjithatë, Kompania veç ka filluar bisedimet me autoritetet relevante për ti kompletuar dokumentet e pronësisë.

**5. ASETET E PAPREKSHME**

	<b>Softuerët (në '000 Euro)</b>
<b>Kostoja / Kostoja e vlerësuar:</b>	
Gjendja më 1 Janar 2008	269
Shtesat gjatë vitit	203
Gjendja më 31 Dhjetor 2008	472
Shtesat gjatë vitit	33
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	505
<b>Amortizimi i akumuluar</b>	
Gjendja më 1 Janar 2008	160
Amortizimi për vitin	41
Gjendja më 31 Dhjetor 2008	201
Amortizimi për vitin	77
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	278
<b>Vlera neto në libra më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>227</b>
<b>Vlera neto në libra më 31 Dhjetor 2008</b>	<b>271</b>

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për fund vitin 31 Dhjetor 2009**

**6. STOQET**

	<b>Më 31 Dhjetor 2009 (në '000 Euro)</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2008 (në '000 Euro)</b>
Materialet dhe materiali shpenzues	31,797	26,849
Qymyri	2,818	2,504
Karburantet	2,196	1,384
Pjesët rezervë	8,313	7,299
Të tjera	9,751	8,747
	<u>54,875</u>	<u>46,783</u>
Provizioni për stoqet me lëvizje të ngadaltë dhe stoqet e vjetruara	<u>(31,630)</u>	<u>(32,226)</u>
	<b><u>23,245</u></b>	<b><u>14,557</u></b>

**7. LLOGARITË E ARKËTUESHME TREGTARE DHE TË TJERA**

	<b>Më 31 Dhjetor 2009 (në '000 Euro)</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2008 (në '000 Euro)</b>
<b>Llogaritë e arkëtueshme tregtare:</b>		
Konsumatorët vendor	339,084	311,272
Konsumatorët e huaj	3,853	3,898
	<b><u>342,937</u></b>	<b><u>315,170</u></b>
Provizioni për dëmtime	<u>(323,053)</u>	<u>(297,428)</u>
	<b><u>19,884</u></b>	<b><u>17,742</u></b>
<b>Llogaritë e arkëtueshme të tjera:</b>		
Paradhëniet furnitorëve	57,810	42,852
Paradhëniet punëtorëve	527	489
TVSH-ja e arkëtueshme	2,418	3,565
	<b><u>60,755</u></b>	<b><u>46,906</u></b>
	<b><u>80,639</u></b>	<b><u>64,648</u></b>

Paradhëniet për furnitorët përfshijnë EUR 999 mijë më 31 Dhjetor 2009 (2008: 1,334 mijë Euro) të cilat u janë dhënë ish njësive të KEK-ut (Transporti, Kujdesi shëndetësor, Restorantet e ushqimi, Elektroinxhinjeringu, Ndërtimtaria, etj) më datën e ndarjes së këtyre njësive nga KEK-u.

Lëvizjet në provizionin për dëmtime:

	<b>2009 (në '000 Euro)</b>	<b>2008 (në '000 Euro)</b>
Gjendja më 1 Janar,	297,428	265,937
Ngarkesa për periudhën	<u>25,625</u>	<u>31,491</u>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor</b>	<b><u>323,053</u></b>	<b><u>297,428</u></b>

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për fund vitin 31 Dhjetor 2009**

**8. PARAJA NË DORË DHE NË BANKË**

	<b>Më 31 Dhjetor 2009 (në '000 Euro)</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2008 (në '000 Euro)</b>
Paraja në banka – në llogaritë rrjedhëse	20,511	118
Paraja në dorë	4	2
	<b>20,515</b>	<b>120</b>

Llogaritë rrjedhëse në banka bartin normë interesi prej 2.65% deri 0.65% në vit (2008: 2.6% në vit)

**9. KAPITALI AKSIONAR**

Më 31 Dhjetor 2008 dhe sipas Regjistrimit të Përkohshëm të Biznesit të lëshuar nga administrata e UNMIK-ut më datë 27 Dhjetor 2005 me numër regjistrimi të biznesit 70325399, kapitali i përgjithshëm i regjistruar kap shumën e 25 mijë eurove. Ai përbëhet nga 25 mijë aksione të zakonshme me çmim prej 1 euro për aksion. Aksionari i vetëm i kompanisë është Korporata Energjetike e Kosovës Holding Sh.a.

**10. REZERVAT**

Rezervat, siç janë detajuar më poshtë, së pari janë llogaritur në librat e Kompanisë si ndryshim ndërmjet kapitalit aksionar të regjistruar dhe vlerës neto të aseteve të Kompanisë siç ishte përcaktuar nga vlerësimi i pavarur në datën e korporatizimit të saj si SH.A. (1 Janar 2005). Këto rezerva janë larguar në dispozicion të aseteve të lidhura. Më tej këto rezerva nuk janë në dispozicion për shpërndarje të aksionarëve.

Komponentët e llogarisë së rezervave janë siç vijon:

	<b>Rezerva e rivlerësimit (në '000 Euro)</b>	<b>Rezervat tjera (në '000 Euro)</b>	<b>Gjithsej (në '000 Euro)</b>
Më 1 Janar 2008	60,304	627,585	687,889
Lirimi i dëmtimit të aseteve të shlyera	(27)	220	193
Më 31 Dhjetor 2008	<b>60,277</b>	<b>627,805</b>	<b>688,082</b>
Lirimi i dëmtimit të aseteve të shlyera	-	-	-
<b>Më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>60,277</b>	<b>627,805</b>	<b>688,082</b>

**11. HUAMARRJET**

	<b>Më 31 Dhjetor 2009 (në '000 Euro)</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2008 (në '000 Euro)</b>
<b>Pjesa jo-rrjedhëse</b>		
Huaja me interes nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave	86,953	8,711
	<u>86,953</u>	<u>8,711</u>
<b>Pjesa rrjedhëse</b>		
Huaja pa interes nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave	10,000	10,000
Huaja me interes nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave	587	-
Mbitërheqja në llogarinë rrjedhëse në bankë	-	2,116
	<u>10,587</u>	<u>12,116</u>
<b>Totali i huave</b>	<u><b>97,540</b></u>	<u><b>20,827</b></u>

***Huaja 1 (Riparimi dhe rehabilitimi i bllokut A5):***

Gjatë vitit 2008, Kompania ka nënshkruar një kontratë huamarrjeje më datë 23 Qershor 2008 më Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për një kredi me limit të përgjithshëm prej 9.4 milion Euro (deri më 31 Dhjetor 2008, Kompania kishte shfrytëzuar EURO 8,710 mijë Euro të kësaj huaje). Kredie është e pagueshme për tetë vjet në anuitete semestrale të barabarta duke filluar nga data 11 Korrik 2010 dhe bart një interes prej 7.43% në vit. Kjo kredi është e siguruar përmes hipotekës në pajisje të cilat kapin vlerën prej 69.5 milionë euro

***Kredia 2 (Hapja dhe operimi i minierës jug-perëndim të Sibovcit):***

Gjatë vitit 2009, Kompania ka nënshkruar një kontratë huamarrjeje më datë 4 Qershor 2009 më Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për një kredi me limit prej 70 milion Euro. Deri më 31 Dhjetor 2009 Kompania kishte shfrytëzuar 16,317,000 Euro të kësaj huaje. Kredia është e pagueshme për tetë vjet në anuitete semestrale të barabarta duke filluar nga data 18 Qershor 2013 dhe bart një interes prej 6% në vit. Kjo kredi është siguruar përmes hipotekës së aseteve të minierës dhe një hipoteke gjenerale të të ardhurave.

***Kredia 3 (Mbingarkimi i sistemeve II & III të minierës jug-perëndim të Sibovcit):***

Gjatë vitit 2008, Kompania ka nënshkruar një kontratë huamarrjeje më datë 24 Qershor 2008 më Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për një kredi me limit prej 75 milion Euro. Deri më 31 Dhjetor 2009 Kompania kishte shfrytëzuar 57,071,000 Euro të huas (deri më 31 Dhjetor 2008, Kompania nuk e kishte shfrytëzuar këtë hua). Kredia është e pagueshme për tetë vjet në anuitete semestrale të barabarta duke filluar nga data 13 Shkurt 2012 dhe bart një interes në prej 7.43% në vit. Kjo kredi është e siguruar përmes hipotekës në pajisje të cilat kapin vlerën prej 85 milionë Euro.

***Kredia 4 (Riparimi dhe rehabilitimi i njësive B1 dhe B2 të termocentralit Kosova B):***

Kompania nënshkroi një kontratë huamarrjeje më datë 27 Janar 2009 më Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për një kredi me një limit prej 5,400,000 Euro. Deri më 31 Dhjetor 2009, Kompania kishte shfrytëzuar 4,752,000 Euro të kredisë. Kredie është e pagueshme për tetë vjet në anuitete semestrale të barabarta, duke filluar nga data 18 Shkurt 2011 dhe bart një interes prej 7.43% për vit. Kjo kredi është e siguruar përmes hipotekës në pajisje.

***Huaja pa interes:***

Gjatë vitit 2005, Kompania ka marr një kredi nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave sipas kontratës që mban datën 29 Shtator 2005 për një shumë prej 10 milion euro dhe ishte e ri-pagueshme në një shumë të vetme më ose para datës 31 Dhjetor 2008. Kjo kredi nuk bart interes dhe nuk është e siguruar me ndonjë kolateral.

**11. HUAMARRJET (VAZHDIM)**

***Mbitërheqja:***

Më 31 Dhjetor 2008, Kompania ka një lehtësi mbitërheqjeje nga një bankë lokale me limit prej 15 milion euro dhe me afat maturimi deri më 31 Korrik 2009 dhe e cila ishte shlyer gjatë vitit 2009. Kjo mbitërheqje bart interes në shkallë prej 4.85% plus Euribor 6 muaj dhe është e siguarur përmes një pengu mbi llogaritë e arkëtueshme.

**12. GRANTET E SHTYRA**

	<b>2009</b>	<b>2008</b>
	(në EUR 000)	(në EUR 000)
Më 1 Janar,	118,893	62,554
Shtesat në pasuri, objekte dhe pajisje	-	28,694
Grantet e pranuar nga Qeveria për investime kapitale	-	24,130
2010 Grantet e pranuar për Opex	10,515	-
Grantet e pranuar ne vitet e mëhershme	-	7,686
Amortizimi gjatë vitit (Shënimi 17)	(4,790)	(4,171)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor,</b>	<b>124,618</b>	<b>118,893</b>

**13. PROVIZIONET**

	<b>Më</b>	<b>Më</b>
	<b>31 Dhjetor</b>	<b>31 Dhjetor</b>
	<b>2009</b>	<b>2008</b>
	(në '000 Euro)	(në '000 Euro)
Gjendja më 1 Janar,	30,000	30,000
Ngarkesa në fitim dhe humbje:		
Largimi i deponisë së hirit dhe çaktivizimi	14,000	-
Provizionet pensionale të personelit	5,211	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor,</b>	<b>49,211</b>	<b>30,000</b>

*Provizioni për çaktivizim dhe largimin e deponive të hirit:*

Gjendja e provizionit më 31 Dhjetor 2009 prezanton vlerësimin më të mirë të Kompanisë për shpenzimeve që kanë të bëjnë me pastrimin dhe përmirësimin e tokës, largimin e deponive të hirit dhe çaktivizimin e centraleve gazifikuese nga stacionet e prodhimit të energjisë. Këto shpenzime bazohen në vlerësimet e brendshme të menaxhmentit, ku menaxhmenti beson që fazat e rrjedhës se parasë në këtë drejtim do të jenë 3-5 vjet.

*Provizionet pensionale të personelit:*

Provizionet e personelit kanë të bëjnë me disa punëtorë të vjetër më të cilët kompania kishte kontrata shërbimi, që specifikojnë përfitimet pas punësimit për tu paguar në kushte të caktuara. Kompania e ka regjistruar këtë provizion duke u bazuar në vendimet e fundit të gjykatës kushtetuese, përmes së cilës gjykata urdhëron gjykatën supreme që të rishikoj vendimet e mëhershme duke marrë parasysh të drejtat kushtetuese të punëtorëve.

Në vitet e mëhershme, Kompania ka ndaluar lidhjen e këtyre kontratave dhe rreptësishtë ka ndaluar pagesat e tilla. Gjatë vitit 2007 bazuar në vendimin e gjykatës kushtetuese në favor të Kompanisë, Kompania i ka hequr provizionet nga librat e saj.



**14. LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA**

	<b>Më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2008</b>
	(në '000 Euro)	(në '000 Euro)
<b>Furnitorët</b>		
Furnitorët vendor	36,867	27,199
Furnitorët e huaj	9,425	13,880
	<b>46,292</b>	<b>41,079</b>
<b>Llogaritë e pagueshme tjera</b>		
Tatimi për transmetuesin publik	522	2,367
Tatimet dhe taksat tjera të pagueshme për periudhat paraprake	-	9,021
Pagat për punëmarrësit	3,449	3,571
Paradhëniet konsumatorëve	72	375
Llogaritë e pagueshme të tjera	673	380
	<b>4,716</b>	<b>15,714</b>
	<b>51,008</b>	<b>56,793</b>

Një pjesë e llogarive të pagueshme të Kompanisë janë të siguruara përmes garancioneve të lëshuara nga bankat lokale. Banka e ngarkon kompaninë më një pagesë mujore prej 4% në vit për instrumentet që përdoren.

**15. SHPENZIMET AKRUALE**

	<b>Më 31 Dhjetor 2009</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2008</b>
	(në '000 Euro)	(në '000 Euro)
Pagesat për koncesione	1,662	1,852
Provizionet për rastet gjyqësore	3,257	1,400
Shpenzimet tjera akruale	2,350	920
	<b>7,269</b>	<b>4,172</b>

Më 31 Dhjetor 2009 Kompania ka rivlerësuar ndikimin e mundshëm të rasteve gjyqësore. Kompania beson që shuma prej 3,257,000 Euro (2008: 1,400,000 Euro) është vlerësimi më i mirë për çfarëdo rrjedhe të mundshme të parasë së gatshme.

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për fund vitin 31 Dhjetor 2009**

**16. SHITJET**

	Më 31 Dhjetor 2009 (në '000 Euro)	Më 31 Dhjetor 2008 (në '000 Euro)
<b>Shitjet e energjisë elektrike</b>		
Konsumatorët brendshëm dhe industrial	79,087	71,848
Konsumatorët familjarë	84,343	78,522
Eksporti i energjisë elektrike	5,669	8,241
	<b>169,099</b>	<b>158,611</b>
<b>Shitjet tjera</b>		
Të hyrat nga shërbimet e ri-kyçjes	97	1,245
Shitja e qymyrit	1,903	1,561
Të tjera	3,293	1,626
	<b>5,293</b>	<b>4,432</b>
	<b>174,392</b>	<b>163,043</b>

**17. TË HYRAT NGA GRANTET**

	Më 31 Dhjetor, 2009 (në '000 Euro)	Më 31 Dhjetor, 2008 (në '000 Euro)
<b>Grantet për qëllime operative:</b>		
Importet e energjisë elektrike	53,682	42,802
Riparimet dhe mirëmbajtjet	-	632
Të tjera	-	90
	<b>53,682</b>	<b>43,524</b>
Amortizimi i granteve të shtyra që lidhen me asetet	4,790	4,171
	<b>58,472</b>	<b>47,695</b>

**18. TË HYRAT TJERA**

	Fund vitin 31 Dhjetor 2009 (në '000 Euro)	Fund vitin 31 Dhjetor 2008 (në '000 Euro)
Shlyerja e detyrimeve të vjetra	3,159	-
Të hyrat nga qiraja	592	232
Ndryshimi në provizionin e stokut	596	-
Të hyrat tjera	697	6,677
	<b>5,044</b>	<b>6,909</b>

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për fund vitin 31 Dhjetor 2009**

**19. SHPENZIMET E PERSONELIT**

	<b>Fund vitin 31 Dhjetor 2009 (në '000 Euro)</b>	<b>Fund vitin 31 Dhjetor 2008 (në '000 Euro)</b>
Pagat neto	37,277	34,192
Kontributet pensionale dhe tatimet	6,188	6,355
Të tjera	3,192	3,130
	<b>46,657</b>	<b>43,677</b>

**20. ENERGJIA ELEKTRIKE DHE SHËRBIMET TJERA PUBLIKE**

	<b>Fund vitin 31 Dhjetor 2009 (in EUR 000)</b>	<b>Fund vitin 31 Dhjetor 2008 (in EUR 000)</b>
Blerjet e energjisë elektrike	49,829	53,923
Karburantet	8,903	9,370
Gazi dhe uji	1,122	1,061
Shkëmbimi i energjisë elektrike	3,397	6,076
Shpërndarja e energjisë elektrike	19,858	15,097
	<b>83,109</b>	<b>85,527</b>

Blerjet e energjisë elektrike paraqesin koston e energjisë elektrike të importuar për harxhim të brendshëm.

**21. SHPENZIMET TJERA OPERATIVE**

	<b>Fund vitin 31 Dhjetor 2009 (në '000 Euro)</b>	<b>Fund vitin 31 Dhjetor 2008 (në '000 Euro)</b>
Shpenzimet e transportit	2,185	1,953
Shpenzimet e sigurimit	2,442	2,410
Shpenzimet e koncesionit	2,038	2,055
Licencat	648	1,196
Shpenzimet jo-prodhuese	1,776	2,005
Të tjera	6,129	3,999
	<b>15,218</b>	<b>13,618</b>

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për fund vitin 31 Dhjetor 2009**

---

**22. NETO SHPENZIMET FINANCIARE**

	<b>Fund vitin 31 Dhjetor 2009 (në '000 Euro)</b>	<b>Fund vitin 31 Dhjetor 2008 (në '000 Euro)</b>
Të hyrat nga interesi në bilancet e mbetur	50	79
Shpenzimet e interesit të huave dhe pagesave të vonuara	(204)	(830)
<b>Neto shpenzimet financiare</b>	<b>(154)</b>	<b>(751)</b>

**23. TATIMI**

Ngarkesat për vitin aktual mund të harmonizohen me profitin sipas pasqyrës së të ardhurave për vitin 2008 siç vijon:

	<b>Fund vitin 31 Dhjetor 2009 (në '000 Euro)</b>	<b>Fund vitin 31 Dhjetor 2008 (në '000Euro)</b>
Humbja para tatimit	4,859	(1,945)
Tatimi në normën prej 10% (2008; 20%)	486	(389)
Humbjet (fitimet) e pa pranuar të përdorura	(486)	389
	<b>-</b>	<b>-</b>

Sipas ligjit me numër 03/L-113 të datës 18 Dhjetor 2008 mbi të tatimet e korporatave, tatimi në të ardhura do të jetë 10% për korporatat që nga data 1 Janar 2009 e më tutje (deri më 31 Dhjetor 2008 ishte 20%).

Kompania ka pasur humbje nga operacionet e saja për vitin 2008 dhe 2007 prandaj edhe nuk ka detyrime për tatime në të ardhura për periudhat që janë marrë në konsideratë.

Humbjet e tatueshme mund të barten përpara për t'u shlyer në pesë vitet e ardhshme pas vitit në të cilin humbja e tatueshme ishte shkaktuar. Gjatë vitit 2008 dhe viteve paraprake Kompania ka pësuar humbje të tatueshme. Nuk janë regjistruar provizione për tatime të shtyre mbi humbjet në të kaluarën apo për diferencat kohore për shkak të pasigurisë se kur apo nëse Kompania do të fillojë të krijojë profite të tatueshme.

## **24. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT**

### **Zotimet:**

Më 31 Dhjetor 2009 Kompania nuk e shfrytëzuar huan nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në shumën e përmendur në shënimin 11. Përveç kësaj gjatë Prillit 2010, Kompania ka nënshkruar dy marrëveshje të reja huaje më Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave në shumën prej 69 milion Euro për qëllime të CAPEX-it.

Më 31 Dhjetor 2009, Kompania ka zotime kapitale 13,228,000 Euro.

### **Çështjet gjyqësore:**

Provizione tjera përveç provizioneve të regjistruara në këto pasqyra financiare, Kompania beson së nuk do të ketë provizione shtesë të kërkuara për rastet e pazgjidhura në gjykatë.

Gjatë 2009, Kompania kishte një konflikt më një furnitor për blerjen e një 'transformatori të përdorur'. Aktualisht Kompania është në kërkim të opsioneve të ndryshme për të zgjidhur këtë çështje miqësisht duke mos përjashtuar edhe mundësinë e kontestit gjyqësor. Varësisht nga rezultatet e mosmarrëveshjes, shuma e përfshirë e humbjes sillet prej 745,000 Euro deri në 2,900,000 Euro.

### **Garancionet bankare:**

Më 31 Dhjetor 2009, garancionet e mbetura të lëshuara në favor të Kompanisë kapin shumën prej 4,500,000 Euro ( më 31 Dhjetor 2008: 35,700,000 Euro)

## **25. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR**

### **Rreziku kreditor**

Kompania i nënshtrohet rrezikut kreditor nëpërmjet aktiviteteve të saja të shitjes. Në këtë respekt, rreziku kreditor për Kompaninë buron nga mundësia që palët e ndryshme mund të mos paguajnë obligimet e tyre sipas kontratës. Shuma e ekspozimit kreditor me këtë rast përfaqësohet nga shumat e bartura të aseteve në datën e bilancit të gjendjes. Prandaj, llogaritë e arkëtueshme tregtare monitorohen në baza mujore dhe konsumatorëve u tërhiqet vërejtja me kohë.

Vlera e bartur e aseteve financiare të regjistruara në pasqyrat financiare, që është shuma neto nga dëmtimet, paraqet ekspozimin maksimal të Kompanisë ndaj rrezikut kreditor.

### **Rreziku i tregut**

Kompania nuk është futur në ndonjë transaksion të "fiksuar/hedging" për të mbuluar ekspozimin e saj ndaj lëvizjes së çmimeve që rrjedhin nga operacionet e saj.

### **Rreziku nga norma e interesit**

Rreziku nga norma e interesit përbëhet nga rreziku që vlera e pasqyrave financiare do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe nga rreziku i ndryshimit ndërmjet maturimit të aseteve që janë me interes dhe maturimit të detyrimeve që janë me interes dhe janë marr për të financuar ato asete (re-pricing risk). Kohëzgjatja për të cilën norma e interesit në një instrument financiar është fikse tregon se deri në çfarë mase ajo është e ekspozuar ndaj rrezikut nga norma e interesit.

Menxhmenti beson se Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit në pasqyrat e saj financiare përveç për huamarrjet, të cilat bartin normë fikse të interesit.

## **25. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

### **Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit reflekton paaftësinë e Kompanisë për të siguruar fonde për të përmbushur angazhimet e saj. Menaxhmenti monitoron drejtpërdrejtë likuiditetin e Kompanisë dhe pozitën e saj të rrjedhës së parasë. Kjo përfshin mirëmbajtjen e indikatorëve të likuiditetit të bilancit të gjendjes, koncentrimin e debitorëve dhe kreditorëve si në terma të miksit të përgjithshëm të financimit si dhe shmangien nga mbështetja e tepërt në konsumatorë të mëdhenj individual, ku një pjesë e financimit është në formë granti nga Qeveria përmes donacioneve.

### **Rreziku nga kursi valutor i këmbimit**

Rreziku nga kursi i këmbimit shfaqet kryesisht kur ekzistojnë llogari të arkëtueshme ose të pagueshme për shkak të transaksioneve me ndërmarrje të huaja. Megjithatë, Kompania nuk është e ekspozuar ndaj ndonjë rreziku domethënës nga kursi i këmbimit për shkak se shumica e transaksioneve kryhen në Euro.

### **Vlera reale e instrumenteve financiare**

Vlera reale është shuma për të cilën një aset mund të këmbehet apo një detyrim mund të shlyhen, ndërmjet palëve me vullnet dhe të mirinformuara në një transaksion duar lirë.

Menaxhmenti beson që vlera e bartur e të gjitha aseteve financiare dhe detyrimeve e reflektuar në pasqyrat financiare është e përafërt me vlerën e tyre reale.

## **26. PRODHIMI DHE HUMBJET E ENERGJISË ELEKTRIKE**

### *Prodhimi i energjisë elektrike:*

Kompania ka dy termocentrale; Kosova A dhe Kosova B për qëllime të prodhimit të energjisë elektrike. Këto termocentrale kanë kapacitet operues më një total prej 860 MW, dhe operojnë me një kapacitet prej 69.8% të kapacitetit të impianteve gjatë 2009 (2008: 66.3%). Kompania tashmë ka përmirësuar kapacitetin operues të termocentraleve përmes investimeve të fundit dhe është në prag të finalizimit të planeve për investime të mëtejshme lidhur më njësitë A3 dhe B2 të termocentraleve për rritje të mëtejshme të nivelit vjetor të prodhimit mbi 70%.

### *Humbjet e energjisë elektrike:*

Kompania pëson humbje të konsiderueshme teknike dhe tregtare të fuqisë së energjisë elektrike gjatë operacioneve të saj. Humbjet teknologjike ndodhin gjatë shpërndarjes së energjisë elektrike sikurse edhe gjatë transformimit të energjisë nga një tension në tensionin tjetër. Humbjet tregtare paraqesin energjinë elektrike të konsumuar nga konsumatorët, të cilën Kompania nuk është në gjendje ta identifikojë dhe faturojë.

Menaxhmenti vlerëson se totali i humbjeve teknologjike të rrymës elektrike, për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2009, është rreth 18% i totalit të energjisë elektrike në dispozicion, ndërsa humbjet tregtare gjatë vitit 2009 janë 16% e totalit të energjisë në dispozicion ( për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2008: humbjet teknologjike ishin 17%, ndërsa humbjet tregtare ishin 15%). Kompania mbulon koston e këtyre humbjeve teknologjike dhe tregtare nga konsumatorët më tarifën e caktuar nga Qeveria e Kosovës përmes zyrës së rregullatorit të energjisë.

## **27. NGJARJET PASUESE**

Qeveria e Kosovës është duke planifikuar për të privatizuar disa njësi të shkëputura të Kompanisë deri në fund të vitit 2011. Operacionet e ardhshme të Kompanisë mund të ndikohen nga këto ngjarje.